

20190200306

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE (*)

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 71/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14, 104/15, 154/15, 192/15, 39/16 dhe 11/18), në nenin 11 në pikën 18-a fjala "enti" zëvendësohet me fjalën "institucioni".

Pas pikës 40 shtohen tri pika të reja 41, 42 dhe 43, si vijojnë:

"41. "Send nga sfera e kulturës" është sendi i cili, para ose pas nxjerrjes së tij të paligjshme, është klasifikuar ose definuar si pjesë e pasurisë nacionale me vlerë artistike, historike, arkeologjike ose vlerë tjetër kulturore ose shkencore (në tekstin e mëtejshëm: pasuria nacionale), në kuptim të këtij ligji dhe marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare.

42. "Send i nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës" është sendi i cili:

- nga territori i Republikës së Maqedonisë është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare ose nuk është kthyer deri në skadimin e afatit të caktuar për nxjerrje jashtë vendit nga neni 96 paragrafi (5) të këtij ligji;

- gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, kurse nga territori i shtetit tjetër është nxjerrë në mënyrë të paligjshme.

43. "Kthimi i sendeve të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës" është kthim fizik i sendeve nga sfera e kulturës në territorin e shtetit nga i cili janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme".

Neni 2

Neni 32-a ndryshohet si vijon:

"Pasuri nacionale në kuptim të këtij ligji, janë të mira, përkatësisht sende nga sfera e kulturës të cilat bëjnë pjesë në ndonjërin nga llojet e trashëgimisë kulturore të tundshme nga nenet 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 të këtij ligji, nëse:

1. janë shpallur si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë ose për trashëgimi kulturore të rëndësishme;

2. janë regjistruar në librin e inventarit si pjesë e përmbledhjes publike (koleksionit) me të cilin menaxhon institucioni publik i muzeut, i bibliotekës ose i kinotekës ose Arkivi;

3. paraqesin pjesë të pajisjes së objekteve fetare të mbrojtura ose përmbledhje sakrale të mbrojtur të bashkësisë fetare të caktuar;

4. përcaktohet se kanë vlerë arkeologjike, historike, artistike ose vlerë tjetër kulturore ose shkencore për Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të cilëve është vendosur në pajtim me nenin 42-a të këtij ligji, me aktvendim për përcaktimin e pasurisë nacionale, për shkak se janë:

- vepër e artistit, disenjatorit ose krijuesit i cili është i rëndësishëm për sferë të caktuar të kulturës në Republikën e Maqedonisë;

- prodhim i kreativitetit vendas, përkatësisht njohurisë;

- karakteristike nga aspekti i trashëgimisë kulturore nacionale;

- të lidhura me personalitet, dukuri ose ndodhi të rëndësishme për historinë nacionale të Republikës së Maqedonisë;

(*) Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Direktivën 2014/60/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 15 maji 2014 për kthimin e sendeve nga sfera e kulturës të marra në mënyrë të paligjshme nga territori i vendit anëtar dhe për ndryshimin e Rregullativës (BE) numër 1024/2012 (tekst i përpunuar), CELEX numër 32014L0060

- të lidhura me monument, tërësi monumentale, zonë kulturore ose mjedis tjetër kulturor i rëndësishëm ose të mira folklorike ose
- të rralla, të rrezikuara ose do të bëhen të rralla në territorin e Republikës së Maqedonisë."

Neni 3

Në nenin 42-a në paragrafin (1) fjalët: "32-a paragrafi (2) pika 4 e këtij ligji, për antikitete dhe sende të tjera të koleksioneve" zëvendësohen me fjalët: "32-a pika 4 e këtij ligji për të mira, përkatësisht sende të tjera të koleksioneve".

Në alinenë 2 fjala "dërguara" zëvendësohet me fjalën "nxjerra", kurse fjalët: "restitucion, përkatësish" shlyhen.

Neni 4

Në nenin 97 paragrafi (3) në pikën 2 fjalët: "të kërkesës së restitucionit" zëvendësohen me fjalët: "për të cilin është ngritur procedurë për kthim".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Antikitete, të mira, përkatësisht sende nga neni 32-a pika 4 të këtij ligji dhe sende tjera artistike dhe sende të tjera të koleksioneve që nuk kanë status të të mirave të mbrojtura sipas dispozitave të këtij ligji, eksporti i të cilave nuk është nën regjim të eksportit të lirë në kuptim të rregullave për punë tregtare- të jashtme, mund të eksportohen në bazë të certifikatës që e lëshon Drejtoria, me mendim të marrë paraprakisht nga institucioni publik kompetent për mbrojtje".

Neni 5

Titulli i nenit 100 dhe neni 100 ndryshohen si vijojnë:

"Kthimi i sendeve të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës

Neni 100

(1) Në procedurë dhe në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara mund të kërkohej kthim i sendit nga sfera e kulturës i cili është nxjerrë në mënyrë të paligjshme:

- nga territori i Republikës së Maqedonisë, kurse ndodhet në territorin e shtetit tjetër;
- nga territori i shtetit tjetër, nëse ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Kthim të sendit nga sfera e kulturës mund të kërkojë shteti nga territori i të cilit sendi është nxjerrë në mënyrë të paligjshme (në tekstin e mëtejme: shteti kërkuar).

(3) Kthim i sendit nga sfera e kulturës mund të kërkohej nga shteti në territorin e të cilit gjendet sendi i nxjerrë në mënyrë të paligjshme (në tekstin e mëtejme: shtet nga i cili kërkohej).".

Neni 6

Titulli i nenit 100-a dhe neni 100-a ndryshohen si vijojnë:

"Organ qendror për koordinimin e kthimit të sendeve të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës

Neni 100-a

(1) Ministria e Kulturës caktohet si organ qendror për koordinimin e kthimit të sendeve nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territoret e shteteve tjera, kurse ndodhen në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe për sende nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, kurse ndodhen në territorin e shtetit tjetër.

(2) Në procedurat për kthimin e sendeve nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territoret e shteteve tjera ,kurse ndodhen në territorin e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Kulturës është e detyruar:

1. të bashkëpunojë me organet qendrore kompetente për koordinimin e kthimit të sendeve nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territoret e shteteve tjera (në tekstin e mëtejme: organi qendror për koordinim);

2. me kërkesë të shtetit kërkuar, i cili Republikës së Maqedonisë i ka dorëzuar kërkesë për kthimin e sendin nga sfera e kulturës i cili në mënyrë të paligjshme është nxjerrë nga territori i tij, ndërmerr aktivitete për gjetjen e sendit dhe për përcaktimin e identitetit të personit që e posedon sendin e kërkuar nga sfera e kulturës. Ministria e Kulturës, do të veprojë pas kërkesës së shtetit kërkuar, nëse kërkesa i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vendit të saktë ose të supozuar në të cilin ndodhet sendi nga sfera e kulturës për të cilin kërkohet kthim;

3. t'i njoftojë organet qendrore për koordinim të shteteve tjera se në territorin e Republikës së Maqedonisë është gjetur send nga sfera e kulturës për të cilin ekziston dyshim i bazuar se është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër;

4. t'u mundësojë organeve kompetente të shtetit kërkuar në afat prej gjashtë muajsh nga dita e dorëzimit të njoftimit nga pika 3 e këtij paragrafi të kontrollojnë nëse sendi për të cilin bëhet fjalë është send nga sfera e kulturës. Nëse kontrolli nuk kryhet në afat prej gjashtë muajsh, dispozitat nga pikat 5 dhe 6 të këtij paragrafi nuk zbatohen;

5. t'i ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen fizike të sendit të kërkuar nga sfera e kulturës në bashkëpunim me shtetin kërkuar;

6. të ndërmarrë masa për parandalimin e veprimeve të cilat e pamundësojnë procedurën për kthim të sendit të kërkuar nga sfera e kulturës;

7. ndërmjetëson midis shtetit kërkuar dhe personit i cili e posedon sendin nga sfera e kulturës, duke përfshirë edhe ndërmjetësimin gjatë lehtësimit të zbatimit të procedurës së arbitrazhit në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë, nëse shteti kërkuar dhe personi që e posedon sendin nga sfera e kulturës japin miratim formal për ndërmjetësim të tillë;

8. menjëherë pas pranimit të kërkesës nga pika 2 e këtij paragrafi, përkatësisht pas pranimit të njoftimit se është filluar procedura për kthimin e sendit të nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës, i njofton organet qendrore për koordinim të shteteve të tjera se në Republikën e Maqedonisë ka filluar procedura për kthimin e sendit nga sfera e kulturës i cili është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër.

(3) Në procedurat për kthimin e sendeve nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, kurse ndodhen në territorin e shtetit tjetër, si dhe për restitucion të trashëgimisë kulturore të shpërndarë jashtë vendit sipas bazave të tjera, Ministria e Kulturës:

1. ndërmerr aktivitete për kompletimin e të dhënave dhe dokumentacionit për sendet e nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës dhe trashëgiminë kulturore të shpërndarë jashtë vendit mbi baza të tjera, që mund të jenë lëndë e kthimit, përkatësisht restitucionit;

2. formon dosje për sendet e nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës dhe të mirat tjera që janë pjesë nga trashëgimia kulturore e shpërndarë jashtë vendit;

3. bashkëpunon me organet tjera shtetërore në Republikës së Maqedonisë kompetente për parashtrimin e kërkesave të restitucionit ose kërkesë për kthimin e sendeve të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës, përkatësisht padi për gjykatat kompetente të shteteve tjera;

4. realizon bashkëpunim me organet qendrore për koordinim në shtete tjera, posaçërisht në aspekt të kryerjes së kontrollit dhe marrjes së masave të nevojshme për mbrojtje fizike të sendit të kërkuar, kur ato veprojnë në përputhje me dispozitat e paragrafit (2) pikat 4 dhe 5 të këtij neni;

5. ndërmerr veprime të tjera si organ qendror për koordinimin e kthimit të sendeve të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës dhe restitucionin e trashëgimisë kulturore të shpërndarë në baza të tjera, në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

(4) Gjatë bashkëpunimit me organet qendrore për koordinim të shteteve tjera, Ministria e Kulturës nëpërmjet bazave elektronike të arritshme të të dhënave për sendet e nxjerra në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës shkëmben informata në formë elektronike, në pajtim me dispozitat nga sfera e mbrojtjes së të dhënave personale.”.

Neni 7

Titulli i neni 100-b dhe neni 100-b ndryshohen si vijojnë:

“Mënyra e ngritjes së procedurës

Neni 100-b

(1) Procedura për kthimin e sendit nga sfera e kulturës i cili është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër, kurse gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë ngritet drejtpërdrejt me padi para gjykatës kompetente në Republikën e Maqedonisë.

(2) Në shtojcë të padisë nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohet:

(a) dokument në të cilin janë dhënë përshkrim i detajuar dhe të dhëna për identifikim të sendit nga sfera e kulturës, në bazë të së cilës vërtetohet se bëhet fjalë për send nga sfera e kulturës i cili ka status të pasurisë nacionale sipas dispozitave të shtetit kërkues;

(b) vërtetim nga organi kompetent i shtetit kërkues se sendi nga sfera e kulturës është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i tij dhe

(v) dëshmi se padia është parashtruar në afatin nga neni 100-g të këtij ligji.

(3) Procedurën për kthimin e sendit nga sfera e kulturës i cili është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, kurse gjendet në territorin e shtetit tjetër e ngre Prokuroria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë drejtpërdrejt me padi para gjykatës kompetente të shtetit në territorin e të cilit gjendet sendi i tillë nga sfera e kulturës.

(4) Ministri i Kulturës miraton vendim për ngritjen e procedurës për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë dhe së bashku me dokumentacionin e plotë (dosje) nga paragrafi (2) i këtij neni e dorëzon te Prokuroria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë. Vërtetimin se sendi është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, i cili është pjesë e dokumentacionit (dosja) për sendin, e lëshon Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

(5) Padia nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni parashtrohet kundër personit që e posedon fizikisht sendin e kërkuar nga sfera e kulturës për nevojat e veta (në tekstin e mëtejshëm: posedues) ose në mungesë të tij, kundër personit i cili fizikisht e posedon sendin e tillë për persona të tretë (në tekstin e mëtejshëm: posedues tjetër).

(6) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, për sendet nga sfera e kulturës që janë nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë dhe për të mirat që janë pjesë e trashëgimisë kulturore të shpërndarë jashtë vendit në baza të tjera, kurse gjenden në territorin e shtetit me të cilin Republika e Maqedonisë ka lidhur marrëveshje bilaterale për restitucion ose kur ajo është paraparë me marrëveshje tjetër ndërkombëtare të ratifikuar, përkatësisht kthim mund të ngrihet edhe në rrugë diplomatike përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, në shtojcë të kërkesës për ngritje të procedurës për restitucion, përkatësisht kthim dorëzohet edhe dokumentacioni nga paragrafi (2) i këtij neni.”.

Neni 8

Titulli i nenit 100-v dhe neni 100-v ndryshohen si vijojnë:

“Kufizimi për ngritje të procedurës

Neni 100-v

(1) Kthimi i sendit nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë në shtetin-anëtar të Bashkimit Evropian dhe nga territori i Republikës së Maqedonisë, mund të kërkohe vetëm për sendin nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme me ose pas 1 janarit të vitit 1993.

(2) Procedura për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nuk mundet të ngritet nëse nxjerrja e sendit nga sfera e kulturës nga territori i shtetit kërkuar nuk është më e paligjshme në kohën kur është kërkuar kthimi i sendit.”.

Neni 9

Pas nenit 100-v shtohen tre tituj të rinj dhe tri nene të reja 100-g, 100-d dhe 100-gj, si vijojnë:

"Afatet për ngritje të procedurës

Neni 100-g

(1) Procedura për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, ndërsa gjendet në territorin e shtetit tjetër dhe për sendin nga sfera e kulturës që është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër, ndërsa gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, mund të ngritet në afat prej tre vjetëve konsideruar nga dita kur organi qendror kompetent për koordinim i shtetit kërkuar ka mësuar për vendin ku gjendet sendi nga sfera e kulturës dhe për identitetin e personit që e posedon sendin, ndërsa më së voni në afat prej 30 vitesh duke llogaritur nga dita e nxjerrjes në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër, përkatësisht në rast kur Republika e Maqedonisë ka lidhur marrëveshje bilaterale për restitucion ose kur ajo është paraparë me marrëveshje tjetër të ratifikuar ndërkombëtarisht më së voni në afat prej 50 vitesh duke llogaritur nga dita e nxjerrjes në mënyrë të paligjshme nga territori i shtetit tjetër.

(2) Në rast kur sendet janë pjesë nga përmbledhjet publike dhe pjesë nga pajisjet e objekteve fetare të mbrojtura ose përmbledhje sakrale të mbrojtura të komuniteteve të caktuara fetare në shtetet ku ata janë sende në procedura të veçanta për mbrojtje sipas legjislacionit nacional, procedura për kthim mund të ngritet në afat prej 75 vitesh, veçanërisht në shtetet ku procedurat nuk i nënshtrohen afatit kohor ose me marrëveshje bilaterale është përcaktuar afati më i gjatë se 75 vjet.

Kompensim i drejtë

Neni 100-d

(1) Në procedurën për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që në mënyrë të paligjshme është nxjerrë nga territori i shtetit tjetër, ndërsa gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë vendos dhe për kompensimin në para për personin që e posedon sendin e kërkuar, nëse personi dëshmon se gjatë marrjes së sendit veproi me kujdes dhe vëmendje të detyruar.

(2) Për të përcaktuar nëse personi që e posedon sendin e kërkuar veproi me kujdes dhe vëmendje të detyruar, ndërsa merren parasysh të gjitha rrethanat e marrjes së sendit nga sfera e kulturës, ndërsa veçanërisht: dokumentacioni për prejardhjen e sendit, lejet për eksport që kërkohe në pajtim me legjislacionin e shtetit kërkuar, çmimi i paguar për sendin, shkalla e

konsultimit në regjistrat qasës për sendet e vjedhura nga sfera e kulturës dhe informacione tjera përkatëse të cilat në mënyrë të arsyeshme mund t'i marrë, si dhe nëse personi ka ndërmarrë aktivitetet që personi i arsyeshëm do t'i ndërmernte nën rrethana tjera .

(3) Në rast të dhurimit ose trashëgimisë, poseduesi nuk do të jetë në gjendje më të mirë nga personi që e ka fituar lëndën e kërkuar nëpërmjet dhurimit ose trashëgimisë.

(4) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni është në barrë të shtetit kërkuar.

(5) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, deponohet në gjykatë në Republikën e Maqedonisë dhe ky kompensim do t'i paguhet personit nga paragrafi 1 i këtij neni në procedurën kur nga organi qendror kompetent për koordinim të shtetit kërkuar gjykata do të marrë njoftim se sendi nga sfera e kulturës i është dorëzuar shtetit kërkuar.

(6) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni, në procedurën për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që në mënyrë të paligjshme është nxjerrë nga territori i shtetit tjetër, ndërsa gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë është i detyruar sendin nga sfera e kulturës ta dorëzojë në afat prej tri ditëve nga dita e deponimit të shumës për kompensim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Shpenzimet e bëra për zbatimin e aktgjykimit për kthimin e sendit nga sfera e kulturës që në mënyrë të paligjshme është nxjerrë nga shteti kërkuar dhe shpenzimet për masat nga neni 100-a paragrafi (2) pika 5 të këtij ligji janë në barrë të shtetit kërkuar.

Dispozitat e veçanta

Neni 100-gj

(1) E drejta e pronësisë së sendit nga sfera e kulturës me kthimin e tij në Republikën e Maqedonisë rregullohet në pajtim me rregullat për pronësi dhe të drejtat tjera reale.

(2) Procedurat për kthim të sendit nga sfera e kulturës që në mënyrë të paligjshme janë nxjerrë nga territori i shtetit tjetër, ndërsa gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë sipas dispozitave të këtij ligji nuk ndikojnë mbi procedurat qytetare ose kundërvajtëse që mund të iniciohen nga shteti i interesuar ose pronari, përkatësisht poseduesi i sendit të vjedhur dhe/ose të nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga sfera e kulturës.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".